

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS-MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE-MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE

Nësisë org. 01 Data/Datumi 04/09/2026
Nr. Prot./Br.Nr. 4869 Nr./faq./Strat./No. pg 2
Prishtinë/Prishtinë/Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01-4869
Datë: 04/09/2026

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G.Z. e Republikës së Kosovës/Nr. 34/18 Nëntor 2022, Prishtinë) nenit 11 të Ligjit nr. 04/L – 138 Për Arsim dhe Aftësim Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7/26 Mars 2013), nënparagrafit 1.11, paragrafit 1 të nenit 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK)- nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Për zbatim në Arsimin Dual të kurrikulës për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike“ në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)

1. Të zbatohet kurrikula për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike“ në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional:
 - 1.1. Kurrikula për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike“ i takon nivelit 3 dhe 4 të Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës;
 - 1.2. Kurrikula për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike“ i takon shkallës 5 dhe 6 të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës;
 - 1.3. Kurrikula për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike“ zbatohet në nivelin I dhe II të Arsimit dhe Aftësimit Profesional;

- 1.4. Kurrikula për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike” zbatohet në klasat 10, 11 dhe 12 të arsimit profesional.
2. Kurrikula për profilin „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike” fillon të zbatohet në IAAP nga viti shkollor 2026/2027.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara, kërkesës së DAAP në MASH me Nr. 4-1619 të datës 27.08.2026 për zbatim në Arsimin Dual të kurrikulës „Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike” në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. AAAPARr;
2. DKA-ve;
3. IAAP-ve;
4. Kabinetit të Ministrit/MASHTI;
5. Zyrës së SP/MASHTI;
6. Departamentit të AAP-së;
7. Arkivit/MASHTI

Hajrulla Çeku

Ministër në detyrë i MASH

